

BEQIR META

**POLITIKAT E SHTETIT SHQIPTAR NDAJ MINORITETEVE
GJATË PERIUDHËS SË MONARKISË***

Periudha e monarkisë ishte një etapë e re në rrugën e vështirë të konsolidimit të shtetit shqiptar. Ndryshe nga shtetet fqinje ballkanike të cilët ishin themeluar e konsoliduar si shtete homogjene dhe unitare nga pikëpamja fetare, gjë që kishte ndikuar shumë në kultivimin e hipernacionalizmit dhe ekskluzivizmit etnik, shteti shqiptar ishte krijuar dhe po zhvillohej si një entitet politik, që bazohej në tolerancën dhe bashkimin e popullsisë etnike shqiptare të tre besimeve të ndryshme, me një maxhorancë të spikatur myslimane. Kjo gjë ndikoi mjaft në pranimin dhe kultivimin e bashkëjetesës në diversitet dhe në shmangien e fenomenit të ekskluzivizmit dhe hipernacionalizmit. Këto diferenca dhe te tjera si këto në zhvillimin e shtetit shqiptar patën një ndikim të rëndësishëm në politikat ndaj minoriteteve. Gjithashtu një ndikim të ndjeshëm ka pasur edhe dëshira e vazhdueshme e shtetit shqiptar për të qenë një model pozitiv në trajtimin e minoriteteve në Ballkan, me shpresën se kështu do të shërbente më mirë mbrojtjes së popullsisë së shumtë shqiptare që jetonte në shtetet fqinje. Kjo tendencë dhe përkujdesje vihet re në të gjithë aktivitetin politiko-diplomatik të shtetit shqiptar gjatë periudhës së Mbretërisë. Por ka ekzistuar edhe një konsideratë tjetër e rëndësishme. I ndodhur përballë fqinjëve të fuqishëm dhe me aspirata kundrejt shtetit shqiptar, Mbreti Zog u përpoq që të bënte një politike pragmatiste dhe sa me luajale ndaj tyre. Qëndrimi tolerant dhe luajal ndaj minoriteteve u konsiderua si një pjesë e kësaj politike dhe si një faktor që do të kontribuonte në stabilitetin e shtetit shqiptar. Në fakt jo vetëm Mbreti, por thuajse i gjithë spektri i nacionalizmit shqiptar, si gjatë kësaj periudhe që po analizojmë por edhe para e pas saj e ka vlerësuar bashkëjetesën dhe trajtimin tolerant të minoriteteve si një politike të pandryshueshme e cila pikësëpari i shërbente interesave kombëtare të lartpërmendura. Kjo është një veçori specifike e nacionalizmit shqiptar në raport me nacionalizmat ballkanike, të cilët kanë konsideruar si një parim themelor të forcimit dhe konsolidimit të

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë: "Monarkia Shqiptare, 1928-1939", organizuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë, 1 shtator 2008.

shteteve të tyre kombëtare politikat e dobësimit, asimilimit dhe spastrimit etnik të pakicave.

Ndryshe nga shtetet fqinje që erdhën duke e ulur ndjeshëm peshën specifike të popullsisë së minoriteteve kombëtare brenda tyre, si rezultat i zhvillimit të vrullshëm të proceseve asimiluese apo politikave të konvertimit dhe spastrimit etnik, Shqipëria e ruajti të pandryshuar peshën specifike të popullsisë së minoriteteve kombëtare, kryesisht për faktin se proceset e lartpërmendura nuk u zhvilluan në Shqipëri. Ky është një dallim thelbësor dhe ky fenomen u ruajt edhe gjatë monarkisë. Kështu p.sh. Greqia e uli peshën e minoriteteve nga 23% në vitin 1920¹, në 4-5% në vitet 30.

Në politikën e shtetit shqiptar u konstatuan raste të spikatura kur shteti u përpoq të frenojë largimin e pakicave. Kështu në vitet 1928-1934 qeveria e A. Zogut mori masa për të penguar emigrimin e vllëve të Shqipërisë për në Rumani. Ata synonin të emigronin për arsye ekonomike. Largimi i tyre u konsiderua nga qeveria si një çështje që dëmtonte prestigjin e shtetit shqiptar dhe miqësinë shqiptaro-rumune. Secili shtet ballkanik do ta kishte mirëpritur dhe inkurajuar këtë emigrim i cili u shkonte përshtat projekteve të tyre për homogjenizimin kombëtar.

Një veçori specifike e qëndrimit të shtetit shqiptar në periudhën e Mbretërisë ndaj minoriteteve është se ai i respektoi të gjitha detyrimet ndërkombëtare dhe zbatoi një politikë tolerante ndaj tyre në mënyrë të njëanshme, duke mos zbatuar parimin e reciprocitetit me vendet fqinje. Megjithëse shqiptarët në Greqi dhe Jugosllavi nuk i kishin të drejtat që gëzonin pakicat në Shqipëri, megjithëse ato në disa raste po vuanin politikat e asimilimit e spastrimit etnik, qeveria shqiptare në asnjë rast nuk u fut në rrugën e zbatimit të sanksioneve reciproke. Në të vërtetë pati kërkesa nga një pjesë e shtypit dhe e administratës shtetërore për marrjen e masave reciproke por ato nuk u pranuan nga Mbreti dhe qeveria.

Qëndrimet e shtetit shqiptar dhe ato të fqinjëve të tij dallonin në mënyrë thelbësore edhe në një çështje tjetër themelore: në qëndrimin ndaj pronës së minoriteteve, e cila është elementi më jetësor i ekzistencës së tyre. Shteti shqiptar gjatë monarkisë, ashtu si dhe para saj, nuk ndoqi asnjëherë politika shpronësimi të drejtpërdrejta apo të tërthorta, të përgjithshme apo selektive kundrejt pakicave. Pakicat në Shqipëri në vitet 20-30 erdhën duke e përmirësuar gjendjen e tyre ekonomike dhe statusin social. Po kështu ata përmirësuan edhe statusin e pronësisë. Shumica e popullsisë minoritare qysh para krijimit të shtetit shqiptar kishte pasur statusin e bujkut çifçi. Ky status erdhi gjithnjë duke u përmirësuar. Ky proces eci përpara veçanërisht gjatë

¹ A. Andreades, *Les Effets Economiques et Sociaux de la Guerre en Grece* (Publications de la Dotation Carnegie pour la Paix Internationale, Paris: "Presses Universitaires de France", 1928, p. 134.

monarkisë me ligjet që dolën për qiramarrjen e tokave bujqësore të cilat favorizonin bujqit. Kështu u përmirësua gjendja ekonomike e tyre dhe u rrit përqindja e atyre që kalonin nga kategoria e bujkut pa tokë në atë me tokën si pronë e tij. I vetmi rast ku qeveria dështoi ishte në konfliktin e pronarit të fshatit Goricë, Maliq bej Frashëri me bujqit e atij fshati. Si rezultat i këtij konflikti pronësor fshatarët e Goricës u larguan nga Shqipëria.

Minoritetet ruajtën të paprekur identitetin e tyre etnik kulturor dhe arsimor i cili erdhi gjithnjë duke u konsoliduar. Rasti më interesant dhe mjaft domethënës ishte ruajtja tërësisht e paprekur e minoritetit shumë të vogël malazez në Vrakë të Shkodrës, me një popullsi prej 1 500 vetash.

Në trashëgiminë historike të monarkisë një vend të rëndësishëm zë edhe mbrojtja e hebrenjve në vitet 30.

Mbretëria zbatoi një politikë tolerante ndaj pakicave, madje u tejkaluan edhe disa kufizime e parashikime të Traktatit të Lidhjes së Kombeve. Shteti shqiptar financoi shkollat minoritare në një masë të konsiderueshme. Pësha specifike e shkollave minoritare në raport me numrin e fshatrave dhe të popullsisë ishte dy herë më e lartë se mesatarja e vendit. Kështu në minoritet kishte 1 shkollë për 829 banorë, ndërsa në popullsinë shqiptare të qarkut të Gjirokastrës kishte 1 shkollë për 1 500 banorë². Në vitin 1934 kur filloi dhe konflikti për shtetëzimin e shkollave greke përqindja e nxënësve shqiptarë në raport me fëmijët e moshës së detyrimit shkollor ishte 36,29%, kurse ajo e fëmijëve të minoritetit grek 79,30%. Përqindja e nxënësve shqiptarë në krahasim me numrin e popullsisë ishte 4,8%, e atyre grekë 9,9%. Përqindja e nxënësve të moshës shkollore që frekuentonin shkollën në minoritetin grek të Shqipërisë ishte 79,30% kurse ajo e nxënësve grekë në Greqi ishte 75%³. Përveç kësaj u toleruan në heshtje edhe financimet e qeverive dhe subjekteve greke e serbe për shkollat e pakicave në Shqipëri, gjë të cilën këto shtete nuk e lejonin kurrsesi brenda territorit të tyre.

Minoriteti grekofon dhe ai vllah kishin përfaqësim më të lartë se ai proporcional në parlamentin dhe në administratën shtetërore shqiptare. Qeveria shqiptare deklaronte se “grekofonët ishin pranuar në radhën e nëpunësve të lartë të shtetit, e oficerëve, policisë, xhandarmërisë në një proporcion që nuk i përshtatet aspak numrit të tyre në raport me popullsinë e përgjithshme të Shqipërisë. Asnjë shtrëngim për sa i përket përdorimit të gjuhës së tyre, gëzimit të pasurisë së tyre, sigurimit të jetës dhe nderit të tyre nuk u është bërë kurrë.

² *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: *AMPJ*), viti 1934, dos. 144, fl. 181-185, MPJ e Shqipërisë – Sekretarit të Përgjithshëm të LK, Tiranë, 3 nëntor 1934.

³ *Po aty*, viti 1935, dos. 297, fl. 309-310, MPJ e Shqipërisë – Sekretarit të Përgjithshëm të LK, 21 dhjetor 1934.

Ndërsa gjithë këto të drejta që u përkasin pakicave janë shkelur në mënyrë të padurueshme nga qeveria greke ndaj pakicës shqiptare në Çamëri⁴.

Gjatë gjithë periudhës popullsia minoritare gëzoi lirinë e plotë të kultit, ritet në kisha kryheshin në gjuhën amtare, nxënësit merrnin edukimin fetar në gjuhën amtare dhe priftërinjtë caktoheshin nga vetë minoriteti⁵.

Krahas kësaj politike liberale ndaj pakicave, Zogu vijoi politikën e tij për konsolidimin e institucioneve kombëtare fetare, politike, arsimore, kulturore etj.

Pikërisht këto përpjekje nuk u mirëpritën nga fqinjët, të cilët u përpoqën me të gjitha forcat ta pengonin procesin e konsolidimit të këtyre institucioneve thelbësore kombëtare dhe në përgjithësi procesin e stabilizimit të shtetit shqiptar.

Fusha më e preferuar e tyre u bë kinse politika për mbrojtjen e minoriteteve e cila u krijonte avantazhe për të ushtruar presion në mënyrë të maskuar ndaj shtetit shqiptar që ai të frenonte apo devijonte procesin e konsolidimit të tij.

Greqia dhe Jugosllavia u përpoqën të përdorin në këtë betejë edhe një pjesë të emigracionit politik shqiptar, kryesisht i besimit ortodoks. Kështu në shkurt 1929 me nxitjen e autoriteteve greke Koço Tasi dhe Foto Dusi duke u paraqitur si përfaqësues të dy organizatave kristiane dhe si interpretë të ndjenjave të popullit shqiptar kristian (ortodoks e katolik), i paraqitën një peticion Lidhjes së Kombeve (LK), ku ankoheshin kundër neneve 223 dhe 232 të Kushtetutës shqiptare, kundër adaptimit të Kodit Civil Francez nga Shqipëria pa bërë përjashtime në legjislacion lidhur me të drejtën e familjes dhe të “minoriteteve kristiane”, për karakterin unik të sistemit elektoral në Shqipëri, duke kërkuar një koleg të veçantë elektoral për kristianët, për politikën fetare të shtetit shqiptar, duke sulmuar përpjekjet e qeverisë për mbështetjen e procesit të krijimit të Kishës Autoqefale Shqiptare. Madje ata nuk ngurronin të sulmonin as Kongresin Kishtar të vitit 1922 të Beratit, i cili kishte vendosur për autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare⁶.

Megjithëse këto ankesa nuk kishin të bënin me minoritetet nacionale, por subjektet që ato i referoheshin ishin qytetarë të kombësisë shqiptare, u morën seriozisht nga sekretari i Lidhjes së Kombeve, Drummond. Ai njoftoi se këtë peticion do t’ua komunikonte anëtarëve të Këshillit i cili do të kërkonte sqarime prej qeverisë shqiptare⁷.

⁴ *Po aty*, viti 1934, dos. 144, fl. 45-46, MPJ – Përfaqësive shqiptare, 27 tetor 1934.

⁵ *Po aty*, viti 1935, dos. 183, fl. 98-100, Xh. Vila për J. Avenol, Tiranë, 24 tetor 1934.

⁶ *Po aty*, viti 1929, dos. 588, fl. 8-17, 28 shkurt 1929.

⁷ *Po aty*, fl. 7, E. Drummond – ministrit të Jashtëm P. Evangjeli, 21 mars 1929.

Shqipëria jo vetëm ndoqi një politikë liberale dhe mirëkuptimi ndaj minoriteteve, por si organizmat shtetërore ashtu edhe ato joqeveritare demonstuan në institucionet e në konferencat ndërkombëtare një frymë të spikatur liberale lidhur me qëndrimin ndaj minoriteteve. I tillë ishte qëndrimi i delegacionit shqiptar në Lidhjen e Kombeve, i cili kryesohej nga intelektuali dhe shtetari i njohur shqiptar Mehdi Frashëri. Ai kërkoi që të formohej një komision i përhershëm i LK për të ndjekur problemet e minoriteteve, por u kundërshtua nga përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha Evropiane, të cilat e konsideronin “reklamimin kolektiv të problemeve të minoriteteve nga një komision permanent, si një rrezik për paqen”⁸.

Një qëndrim po kaq liberal mbajti delegacioni jozyrtar shqiptar në Konferencën Ballkanike, i cili gjithashtu kryesohej nga politikani i njohur shqiptar, Mehmet Konica. Delegacioni bëri presion që në këto konferenca të diskutohej çështja e minoriteteve⁹, dhe që vendet ballkanike të respektonin të drejtat e pakicave. Ai deklaroi me vendosmëri se “shteti shqiptar ishte partizan i zjarrtë i bashkimit ballkanik të bazuar në parimet e drejtësisë dhe miqësisë së plotë dhe se nuk do ishte e mundur që të bëhej ndonjë hap në këtë drejtim pa u njohur të drejtat e pakicave”¹⁰. Delegacioni ishte porositur më parë nga Mbreti Zog që të tregonte energjinë më të madhe për mbrojtjen e shqiptarëve përtej kufijve¹¹. Delegacioni shqiptar kundërshtoi pikëpamjen greke dhe jugosllave se njohja e të drejtave të pakicave do të përbënte një rrezik për vendin ku ato jetonin duke e cilësuar atë një argument të paqëndrueshëm dhe duke i kundërvënë asaj shembullin e shtetit shqiptar, i cili, qysh prej krijimit të tij, kishte ndjekur një politikë shembullore unike në Ballkan në respektimin e pakicave: “Ja pra, ne nuk po shohim asnjë rrezik që mund të na kanoset nga ana e këtyre pakicave. Rreziku do të ekzistonte padyshim në qoftë se sillemi ndaj këtyre minoriteteve sikur të ishin robër lufte”, deklaronte Mehmet Konica në një nga këto konferenca¹². Delegacioni shqiptar së bashku me atë bullgar kërkuan garanci dhe krijimin e një instrumenti të ri efektiv për mbrojtjen e minoriteteve, si dhe zbatimin e barabartë të këtyre parimeve nga shtetet ballkanike. Ndërsa përfaqësuesit jugosllavë e injoruan problemin e minoriteteve¹³. I gjithë shtypi shqiptar mbështeti përpjekjet e delegacionit

⁸ *Ora*, “Çështja e pakicave përpara Lidhjes së Kombeve”, Tiranë, 21 shtator 1930.

⁹ *Miku i Popullit*, “Një komunikatë sqaronjëse”, 18 shtator 1931.

¹⁰ Deklaratat e para të delegatëve të Konferencës Ballkanike, “Gazeta e Korçës”, 24 tetor 1931.

¹¹ Konferenca e Stambollit, *Miku i Popullit*, 23 tetor 1931.

¹² Nga Konferenca e Instanbullit, *Miku i Popullit*, 15 nëntor 1931.

¹³ *AMPJ*, viti 1931, dos. 52, fl. 196-207, Raport i Ihsan Libohovës mbi diskutimet në Konferencën II Ballkanike, 1 dhjetor 1931.

shqiptar për afirmimin dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve dhe kritikoi rastet kur ai u detyrua të bënte lëshime në këtë drejtim me qëllim që të arrihej kompromisi në konferencat ballkanike.

Megjithëse gjithë periudha e ekzistencës së shtetit shqiptar karakterizohet nga tendenca e përgjithshme e respektimit të të drejtave themelore të minoriteteve, kanë ekzistuar edhe raste episodike për probleme të veçanta ku ka pasur mosmarrëveshje e pakënaqësi. Rasti më i rëndësishëm ishte ai i viteve 1934-1935 kur shteti shqiptar vendosi shtetëzimin e të gjitha shkollave private në Shqipëri. Në fakt kjo masë u ndërmor në kuadrin e krizës së marrëdhënieve shqiptaro-italiane, por njëkohësisht ajo synonte edhe dy objektiva të tjera: 1 – të unifikonte arsimin kombëtar në shembullin e shteteve të tjera europiane, me qëllim që të shmangte diversitetin e theksuar politik, arsimor, edukativ, moral e shpirtëror që kishin shkaktuar këto shkolla si rezultat i veprimit për një periudhë të gjatë dhe i konkurrencës së fortë që ato i bënë arsimit publik për arsye të vështirësive financiare e organizative që kishte shteti i atëhershëm shqiptar. Në Shqipëri ekzistonte një situatë specifike pasi ajo e kishte fituar pavarësinë kombëtare rreth një shekull më vonë se popujt e tjerë fqinjë. Në sundimin osman shqiptarët ishin privuar nga e drejta për të kultivuar kulturën e gjuhën kombëtare dhe si rrjedhojë, arsimit në Shqipëri ndryshonte sipas krahinave: myslimanët frekuentonin shkollat otomane, ortodoksët shkollat greke, dhe në krahinat afër vendeve sllave ato serbe e bullgare, katolikët frekuentonin shkollat italiane ose austriake. Kleri i lartë i krahinave të ndryshme në Shqipëri ishte me kombësi të huaj dhe mbronte arsimin në gjuhën e huaj që ishte e tij. Kjo anomali nuk mund të vazhdonte gjatë. Zgjidhja e vetme që i shërbente ekzistencës së shtetit ishte laicizmi i tij, krijimi i arsimit publik dhe nacionalizimi i të gjitha institucioneve qytetare e kulturore. Bashkimi moral e politik i shqiptarëve ishte tronditur nga diversiteti kulturor që kishte mbretëruar gjatë shekujve midis shqiptarëve. Pra, ishte jetik aplikimi i këtij parimi për të gjitha institucionet politike e sociale. Kjo masë u konsiderua si një domosdoshmëri për forcimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare dhe të karakterit kombëtar e unik të shtetit shqiptar. Një qëllim tjetër ishte edhe ndalimi i propagandave të huaja që gëlonin në këto shkolla, të cilat gjithmonë kishin vepruar në kundërshtim me interesat e shtetit shqiptar. Fakti që kjo masë nuk drejtohej në mënyrë specifike kundër shkollave greke provohej edhe nga numri i shkollave të tjera të mbyllura: 10 institucione parashkollore, 44 shkolla fillore dhe 13 gjimnaze e shkolla profesionale. Ndërsa numri i shkollave fillore greke ishte 10¹⁴. Pra dukej qartë se qëllimi kryesor i këtij ndryshimi nuk ishin

¹⁴ “Protection de minorites: Question de l’application des dispositions de l’article 5, alinéa 2, de la déclaration albanaise du 2 octobre 1921”, marrë nga *Buletini i Lidhjes së Kombeve*.

shkollat minoritare, por ato u përfshinë për arsye të veprimit të përgjithshëm të ligjit.

Qeveria shqiptare deklaroi se synonte që t'i jepte fund regjimit të kapitulacioneve të vjetra që e kishte shndërruar Shqipërinë në një vatër të propagandës së huaj. Ky ndryshim, thuhej, nuk ishte provokuar prej problemeve të shkollave të pakicave, "por prej kujdesit të një vendi, të penguar prej shumë kohësh në zhvillimin e vet kombëtar për të ardhur në kulturën tradicionale". Ajo deklaronte se shtetëzimi i arsimit nuk ishte një masë e jashtëzakonshme dhe anormale, pasi edhe "shtete, që liberalizmi intelektual i të cilave nuk mund të diskutohej, kishin praktikuar për një kohë të gjatë këtë regjim të monopolit në rrethana që prej tyre ishin gjykuar si të volitshme"¹⁵.

Popullsia e minoritetit grekofon nuk e mirëpriti këtë shtetëzim, megjithëse të gjitha elementet e tjerë të shkollës si mësimi në gjuhën greke, tekstet mësimore të botuara në Greqi vijuan si më parë. Qeveria greke dhe konsujt e saj nxitën nënshkrimin e peticioneve nga popullsia minoritare dhe ndërmorën një fushatë politike, diplomatike dhe propagandistike shumë intensive duke amplifikuar rreziqet që i vinin minoritetit nga ky ligj. Këshilli i Lidhjes së Kombeve ia parashtrori çështjen Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës për të dhënë një mendim ligjor mbi të drejtën e qeverisë shqiptare për të shtetëzuar shkollat private grekofone. Përveç Greqisë edhe qeveria italiane u përpoq ta siluronte pozitën e qeverisë shqiptare duke kërkuar t'i paraqiste shkollat fetare katolike si shkolla minoritare.

Qeveria shqiptare u përpoq ta mbronte pozitën e saj duke pohuar se ajo nuk kishte shkelur ligjet dhe angazhimet ndërkombëtare për mbrojtjen e minoriteteve të cilat nuk përmbanin asnjë obligim që një shtet t'u akordonte minoriteteve një trajtim superior në raport me shumicën, në bazë të një ligji të përgjithshëm e mbi të gjitha kur reciprociteti u refuzohej minoriteteve shqiptare në vendet e tjera¹⁶. Qeveria shqiptare deklaronte se lëvizjen antishqiptare që kishte filluar shtypi grek dhe elementet turbullues me anë të mitingjeve në Greqi nuk ishin shkaktuar nga shqetësimi se gjuha greke ishte në rrezik dhe se elementi grekofon po shqiptarizohej, por vetëm e vetëm se ata po shihnin qartë se privilegjet e tyre shkollore e fetare, që kishin trashëguar nga koha e Turqisë, të cilat i përdornin si vegël politike, nuk lejoheshin më në Shqipëri. Me këtë masë të qeverisë shqiptare ata panë se ishte rrezikuar qëllimi i tyre i vërtetë: shpresat imperialiste që kishin kundrejt Shqipërisë¹⁷.

¹⁵ AMPJ, viti 1935, dos. 297, Parashtrësë e qeverisë shqiptare, nënshkruar nga Mehdi Frashëri, për Këshillin e LK, 1 mars 1935.

¹⁶ Po aty, viti 1934, dos. 255, fl. 142-145, Ministri i Jashtëm i Shqipërisë – Sekretarit të Përgjithshëm të LK, Joseph Avenol, Tiranë, 23 korrik 1934.

¹⁷ Po aty, dos. 144, fl.45-46, MPJ – Përfaqësive shqiptare, 27 tetor 1934.

Gjatë debateve me Greqinë në Lidhjen e Kombeve për shkollat e minoritetit grek qeveria shqiptare mendoi të parashtronte edhe mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në Greqi, por nuk veproi aktivisht për arsye se i mungonte mbështetja ndërkombëtare dhe për faktin tjetër se grekët kishin shtypur çdo përpjekje të shqiptarëve për të kërkuar të drejtat e tyre në Lidhjen e Kombeve.

Gjatë debateve përfaqësuesi grek Politisi, akuzoi qeverinë shqiptare se kishte shkelur privilegjet e Patriarkanës, të cilat i konsideroi si një të drejtë të fituar; Protokollin e Korfuzit, Protokollin e Kapshticës dhe Marrëveshjen Titoni – Venizellos të vitit 1919. Përfaqësuesi shqiptar i kundërshtoi të gjitha këto pretendime duke argumentuar se ato kishin qenë episode historike jodefinitive, të cilat nuk kishin vlerë reale juridike në këtë kohë. Ai veçanërisht shpjegoi se shtetit të pavarur shqiptar nuk mund t'i imponoheshin kapitulationet e Patriarkanës së Stambollit të akorduara nga sulltan Fati Mehmeti në vitin 1453, pas pushtimit të Stambollit. Këto privilegje ishin përdorur prej Patriarkanës si një armë shpirtërore dhe morale tepër aktive kundër lëvizjeve çlirimtare të gjithë popujve ortodoksë të Perandorisë Osmane¹⁸.

Gjykata e Hagës me 8 vota pro dhe 3 kundër dha mendimin juridik konsultativ për Këshillin e LK se vendimi i qeverisë shqiptare, megjithëse kishte karakter të përgjithshëm, dëmtonte përpjekjet e minoritetit për të ruajtur identitetin dhe arsimin në gjuhën amtare dhe cenonte barazinë faktike të tij me maxhorancën. Ndërsa pakica e Gjykatës me në krye juristin e njohur Cecil Hurst e konsideronte të drejtë ligjin shqiptar i cili vendoste arsimin publik në të gjithë vendin dhe për gjithë popullsinë, duke e konsideruar një privilegj moszbatimin e këtij ligji në minoritet.

Qeveria shqiptare e zbatoi me korrektësi vendimin e Gjykatës së Hagës, por u përpoq që të arrinte një marrëveshje me qeverinë greke që edhe ajo të hapte shkolla shqipe në Çamëri.

Debatin shqiptaro-grek për çështjen e shtetëzimit të shkollave shtetet ballkanike u përpoqën ta shfrytëzonin për interesat e tyre. Jugosllavia u përpoq të përfitonte për të forcuar më tej pozitat e pakicës sllave në Vrakë, Rumania për të zgjeruar shkollat rumune për vllahët në Shqipëri¹⁹.

Qeveria shqiptare iu drejtua edhe asaj britanike për të ndihmuar në arritjen e një kompromisi me grekët. Përgjigjja e ministrit anglez në Tiranë ishte dekurajuese. Ai kritikoi qeverinë shqiptare se “në çështjen e shkollave ajo

¹⁸ *Po aty*, viti 1935, dos.77, Përgjigje e Mehdi Frashërit në seancën publike të Gjyqit të Hagës, 12 mars 1935.

¹⁹ *Po aty*, dos.297, fl. 181, Shënime të ministrit të Jashtëm dërguar A. Zogut, 24 prill 1935.

nuk kishte vepruar me abilitet²⁰. Madje në ditët e para të majit marrëdhëniet me ministrin britanik në Tiranë u acaruan më tej për shkak të një lajmi që ai kishte marrë se qeveria shqiptare do të sistemonte 1 500 familje refugjatësh kosovarë në zonën e minoritetit grekofon²¹. Ministri i Jashtëm shqiptar e përgënjeshtroi këtë lajm dhe më tej i kërkoi përfaqësuesit britanik që qeveria e tij të bënte më shumë për mbrojtjen e të drejtave të pakicave shqiptare, por nuk mori asnjë përgjigje për këtë kërkesë. Megjithëse në disa segmente të ulëta të administratës pati propozime dhe tendenca të veçanta për të përdorur metodën e kolonizimit dhe metoda të tjera me qëllim që të dobësonin elementin grekofon këto u hodhën poshtë nga autoritetet e larta shtetërore dhe nuk u ndërmor asnjë masë në këtë drejtim. Kështu, ndryshe nga vendet e tjera ballkanike ku procesi i kolonizimit në kurriz të minoriteteve ishte i thelle dhe intensiv, në Shqipëri ai nuk ka ekzistuar.

Në këtë kohë qeveria shqiptare e ndjeu thellë se uniteti i brendshëm i vendit ishte i kërcënuar seriozisht sepse përfaqësuesi italian i përkrahur nga ai spanjoll në LK po përpiqeshin t'i jepnin statusin e minoritetit edhe popullsisë katolike shqiptare. Qeveria shqiptare i shmangu komplikacionet e mëtejshme duke deklaruar se ajo po negocionte një marrëveshje (konkordat) me Vatikanin për këtë çështje.

Në të vërtetë problemi i shkollave nuk ishte i vetmi që shkaktoi debate midis qeverisë shqiptare e minoritetit. Kështu popullsia e katundeve grekofone të qarkut të Delvinës dhe të Dropullit mbajti vazhdimisht një qëndrim të ashpër kundër përpjekjeve për afirmimin e Kishës Autoqefale Shqiptare²². Krerët dhe nxitësit kryesorë të propagandës kundër KOASH ishin agjentët grekë dhe konsullatat greke në Prefekturën e Gjirokastrës. Pas masave që mori qeveria kundër krerëve që nxitën protestat kundër KOASH, kjo rezistencë u fashit disi²³. Gjithashtu u modifikua statusi i KOASH, neni 8, i cili lejonte që zëvendësit e kryepeshkopit dhe episkopëve të mund të ishin individë të kombësive joshqiptare, me qëllim që të kënaqej elementi grekofon pa i shkaktuar shtetit ndonjë rrezik apo dëm²⁴.

²⁰ *Po aty*, dos.94, Ministri i Jashtëm Xhaferr Vila – A. Zogut, 30 prill 1935.

²¹ *Po aty*, fl. 7-9, Letër e Xh. Vilës – Mbretit Zog, 11 maj 1935.

²² *AQSh*, Fondi MPB, viti 1929, dos.119/A, fl. 152, Mitropolit i Gjirokastrës Ambrozi – Kryeministrit Kostaq Kota.

²³ *Po aty*, fl.106, Prefektura Gjirokastrë – MPB, 15 qershor 1929.

²⁴ *Po aty*, dos.119/2A, Prefekti i Korçës, Hil Mosi – MPB, 29 qershor 1929.

